



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.2584, datë 10.07.2015**

**Për**

**“Dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz ”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.07.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Shkronja g, e nenit 8, nenet 62 deri 79 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në republikën e Shqipërisë”);
2. Ligji Nr. 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative”;
3. VKM Nr. 468, datë 30.05.2013 “Për miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e broadband-it”, i ndryshuar

4. Vendimi Nr.466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.
5. Vendimi Nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” i ndryshuar,
6. Rregullore për Autorizimin Individual, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2395, datë 15.12.2013.
7. Vendimi i Këshillit Drejtues Nr.2599, datë 22.05.2015 për “Miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO dhe Njoftimin e fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “*Dhënia në përdorim e frekuencave nga brezi 900 MHz për sistemet GSM*”, Ref. 4x2-2015.
8. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

### K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Kopje e Faturave te pagesave të kryera nga sipërmarrësi “**Vodafone Albania**” sh.a.
  - Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);
  - si dhe,
- duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

### V Ë R E N :

1. Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin Nr.2577, datë 22.06.2015, për “Miratimin e Njoftimit të fituesit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt, “*Dhënia në përdorim e frekuencave nga brezi 900 MHz për sistemet GSM*”, Ref. 4x2-2015 miratoi Njoftimin e Fituesit, sipas Shtojca 15 - Formulari i Njoftimit të Fituesit.
2. AKEP, bashkëlidhur shkresës Nr.1001/23 Prot., datë 23.06.2015 i ka dërguar “Vodafone Albania” sh.a., Formularin e Njoftimit të Fituesit, Nr.1001/22 Prot., datë 23.06.2015, sipas Shtojca 15, të përfshirë në dokumentacionin e tenderit.
3. “Vodafone Albania” sh.a. brenda afatit 7 (shtatë) ditë, nga data marrjes së Formularit të njoftimit të fituesit, njoftoi kryerjen e pagesave, të mëposhtëme:
  - a) Çmimin e ofertës me shumën **300.016,5 (treqindë mijë e gjashtëmbëdhjetë pike pesë) Euro**, datë 29.06.2015, në Logarinë bankare me emërtim: *Qeveria Shqiptare*.
  - b) Pagesa vjetore (për 6 muaj) **63.000 (gjashtëdhjetë e tremijë) lekë** për përdorimin e frekuencave per tre të drejta përdorimi nga 2 kanale prej 200 KHz të brezit 900 MHz secila sic përcaktohet në Dokumentat e Tenderit, datë 29.06.2015.

- c) Pagesa vjetore (për 6 muaj) **181.440 (njëqindtetëdhjetënjëmijë e katërqindedyzet) lekë** për tarifën e shërbimit për shërbimet e radiokomunikimit, për tre të drejta përdorimi nga 2 kanale prej 200 KHz secila të brezit 900 MHz sic përcaktohet në Dokumentat e Tenderit, datë 29.06.2015.

Pagesa sipas pika a) të mësipërme, është kryer në Bankën e Shqipërisë, *Qeveria Shqiptare* në EUR me Nr: AL89 1011 1008 0000 0000 2111 001E .

Pagesat sipas pika b) dhe c) të mësipërme, janë kryer në llogarinë bankare të AKEP, me Nr: AL30214112090 111113869030117.

## P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në sa më sipër, në kompetencat që i janë dhënë nga:

1. Ligji Nr.8485 dt 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”;
2. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, për ”Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, gërma g, neni 8, nenet 62 deri 79, neni 114 dhe neni 115 ,
3. VKM Nr. 468, datë 30.05.2013 “Për miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e broadband-it”, i ndryshuar
4. VKM Nr.466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,
5. Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr.1252, datë 10.9.2008, i ndryshuar,
6. Rregullorja për Autorizimin Individual, miratuar me VKD Nr. 2395 datë. 15.12.2013.
7. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

## V E N D O S :

1. Të pajisë sipërmarrësin “ Vodafone Albania” sh.a. me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave nga brezi 900 MHz, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Sipërmarrësi do të shfytëzojë frekuencat e dhëna nëpërmjet procedurës së tenderit publik me objekt **“Dhënia në përdorim e frekuencave nga brezi 900 MHz për sistemet GSM”, Ref. 4x2-2015**, në përputhje me kushtet e pranuar të Dokumentit të Tenderit.
3. Afati i vlefshmërisë së Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz të fituara nëpërmjet tenderit me objekt **“Dhënia në përdorim e frekuencave nga brezi 900 MHz për sistemet GSM”, Ref. 4x2-2015** do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, nga 01.07.2015 deri në 01.07.2030.
4. E drejta e përdorimit pa kufizim teknologjik të frekuencave të dhëna me këtë autorizim individual fillon nga data 01.09.2015.

5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

**ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. **Alban KARAPICI** \_\_\_\_\_
2. **Anila DENAJ** \_\_\_\_\_
3. **Ketrin TOPÇIU** \_\_\_\_\_
4. **Klarina ALLUSHI** \_\_\_\_\_